



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.07.2025
REFERENC-Ë:	25/4359/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Worldmatic" Sh.p.k. Thërrmim dhe seperim i gëlqerorëve mergelorë, Gremnik, Komuna e Klinës
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.25/4359/MMPHI për t'u pajisur me Leje Mjedisore, të operatorit "Worldmatic" Sh.p.k. për veprimtarinë: Thërrmim dhe seperim i gëlqerorëve mergelorë, Gremnik, Komuna e Klinës dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,

Me respekt!

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/4359/MMPHI
Datë: 17.07.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.25/1070/MMPHI e operatorit "Worldmatic" Sh.p.k. për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Thërrmim dhe seperim i gëlqerorëve mergelorë, në pjesën e ngastrave kadastrale, sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.:19/6266/1-ZSP/09/20, të lëshuar me datë: 13.01.2020, me nr.P-71010065-00002-0, zona kadastrale Perqevë dhe nr.P-71010072-00001-1, zona kadastrale Sferkë, Komuna e Klinës, ngastrat kadastrale

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të mirëmbahet sistemi i spërkatjes me vrushkuj uji për eliminimin e pluhurit nga procesi teknologjik i thyerjes dhe seperimit të gëlqerorëve mergelorë;
- T'i përmbahet kushteve të thërrmimit dhe seperimit, sipas përshkrimit në aplikacion;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;

- Vazhdimisht të bëhet spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara, të cilat shfrytëzohen për bartjen e gurit gëlqeror nga eksploatimi deri te lokacioni ku kryhet aktiviteti i thërrmimit dhe seperimit të gëlqerorëve mergelorë;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kritereve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI;

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës me Nr.Prot.25/1070/MMPHI për t'u pajisur me Leje Mjedisore, nga operatori "Worldmatic" Sh.p.k. pajiset me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Thërrmim dhe seperim i gëlqerorëve mergelorë, në pjesën e ngastrave kadastrale nr.P-71010065-00002-0, zona kadastrale Perqevë dhe nr.P-71010072-00001-1, zona kadastrale Sferkë, Komuna e Klinës, sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.:19/6266/1-ZSP/09/20, të lëshuar me datë: 13.01.2020, MMPHI konstaton se operatori i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore, sipas Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 811283267, d atë: 18.03.2019, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Vendimit të Pëlqimit Mjedisor me Nr.:19/6266/1-ZSP/09/20, datë: 13.01.2020, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Leje për aktivitete të veçanta për sortues, 901/KPMM/2025, me Nr.Prot.1699, data e lëshimit 30.05.2025, me kohëzgjatje deri me datë: 25.04.2030, të lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;

MMPHI, pas pranimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore dhe vizitës në terren të realizuar me datë: 26.06.2025, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumentacionit si në vijim:

- Raportin e pluhurit total të depozituar

Operatori ka sjellë dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur më lartë me datë: 04.07.2025

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, dhe nenin 13, të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, merrë vendim që operatorit të lartëcekur t'i lëshohet Leja Mjedisore.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës Klinë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.